



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 65/2 prot.

Tiranë, më 26. 03. 2025

### V E N D I M

**Nr. 65, datë 26. 03. 2025**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 256 Regj., datë 24.12.2024, të paraqitur nga B. B. kundër Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, të Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminim të fëmijëve të saj të mitur S. B.dhe E. B., për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, B. B., në mes të tjerash informon se: “...Jam nëna e 4 fëmijëve, 2 prej të cilëve vazhdojnë shkollën 9 - vjeçare “Asdreni”, përkatësisht në klasën e shtatë dhe të tretë.

Në muajin tetor, jam lajmëruar nga mësuesja kujdestare e fëmijëve, për të përgatitur dokumentacionin për përfitimin e bursës në bazë të VKM Nr. 666. Jemi një familje me probleme social-ekonomike, që nuk trajtohem me ndihmë ekonomike prej një periudhe kohore disa vjeçare. Shkak ka qenë penalizimi që më është bërë, pasi nuk kam pasur informacion dhe nuk kam deklaruar pagën në zyrën e Ndihmës Ekonomike (Kisha deklaruar që kisha filluar punë por jo pagën, të cilën edhe sot nuk e kam marrë nga punëdhënësi).

Në muajin nëntor kam dorëzuar dokumentacionin për të përfituar fëmijët trajtimin me bursë sipas parashikimeve të VKM-së Nr. 666, pasi jam familje që nuk trajtohem me ndihmë ekonomike.

Në muajin dhjetor 2024, ka dalë lista me emrat e përfituesve, por fëmijët e mi nuk rezultojn pjesë e kësaj liste. Ndërkohë që edhe vitet e kaluara kam dorëzuar të njëjtin dokumentacion dhe fëmijët kanë qenë përfitues të bursës.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

*Kam kontaktuar me drejtoreshën e shkollës për të marrë një përgjigje dhe nga ana e saj më është komunikuar që arsyet e mospërfitimit i jep Bashkia Korçë dhe jo ajo.*

*Jam paraqitur pranë Bashkisë Korçë dhe kam marrë informacion se arsyet e mospërfitimit të bursës, lidhen me mungesën e vërtetimit si punëkërkuar të papunë për të dy prindërit. Ndërkohë që këtë dokumentacion për shkak të penalizimit nuk mund ta marrë nga ana e Zyrës së Punës.*

*Po ju drejtohem ju si institucion për të më zgjidhur këtë problematikë, pasi jetoj në kushte të vështira ekonomike. Jetojmë 6 persona në një dhomë dhe 13 persona në një banesë...Fëmijët e mi me sakrificë të madhe frekuentojnë shkollën... ”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike, si dhe përfshirjen e fëmijëve të saj në listën e përfituesve të VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 (së ndryshuar), “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 65 prot., datë 09.01.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë dhe Shkollës 9 vjeçare “Asdreni”, lidhur me pretendimet e ankueses, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e ankueses.
  - Informacion mbi arsyet përse fëmijët e subjektit ankues nuk kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
  - Informacion lidhur me numrin e fëmijëve (listën emërore), që kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, duke specifikuar kriterin për të cilin kanë përfituar, për secilin rast.
  - Informacion nga ana e Shkollës “Asdreni”, Korçë, lidhur me frekuentimin e mësimit nga ana e nxënësve S. B. dhe E. B., gjatë vitit shkollor 2023-2024 dhe 2024-2025. A kanë pasur mungesa gjatë këtyre viteve shkollore?
- Në përgjigje sa më sipërcituar, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, me shkresën<sup>3</sup> nr. 51 prot., datë 17.01.2025, ka parashtruar në mes të tjerash se:

Për përcaktimin e “Kuotave financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore publike”, vlerësimi i kriterëve është bërë bazuar në VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore publike”, të ndryshuar.

Referuar VKM-së sipërcituar, Bashkia Korçë thekson se: “B. B. ka kërkuar bursë për fëmijët e saj S. B. dhe E. B. nxënës në shkollën “Asdreni”. Sipas informacionit nga Drejtoria e shkollës, prindi ka dorëzuar dokumentet për të aplikuar për bursë pranë kësaj drejtorie, nga shkolla janë pranuar dokumentet dhe janë dorëzuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes. Nga ana jonë dokumentacioni i dorëzuar është pranuar dhe është shqyrtuar së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të të gjithë nxënësve që kanë aplikuar për bursë.

<sup>3</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 65/1 prot., datë 21.01.2025.

Të dy nxënësit nuk kanë qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025 pasi dokumentet që ka dorëzuar prindi për aplikim kanë qenë të paplota. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara nxënësit klasifikohen në kriterin 2.1/c të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar me vendimin nr. 511, datë 21.07.2022 dhe dokumentacioni që kërkohet për të aplikuar për bursë sipas këtij kriteri është:

- Certifikatë personale.
- Certifikatë familjare.
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës).
- Vërtetim të ardhurash/page për çdo anëtar madhor të familjes.
- **Vërtetim regjistrimi si punëkërkues i papunë për çdo anëtar madhor të familjes.**
- Vërtetim pagese pension pleqërie.
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes.

Për këtë rast, pranë shkollës nuk janë dorëzuar vërtetimet si punëkërkues i papunë për dy prindërit.

Mungesa e këtij dokumentacioni ka qenë dhe shkaku pse nxënësit nuk kanë qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025. Për të qenë përfitues i bursës duhet që të kishin dorëzuar të gjitha dokumentet që kërkohen sipas kriterit në të cilin klasifikohen, si dhe duke respektuar afatet kohore për dorëzimin e këtij dokumentacioni.

Për vitin shkollor 2024-2025 skualifikimet nga bursat kanë qenë për mungesë dokumentacioni/ dokumentacion i pasaktë ose i korrigjuar dhe dokumentacion i dorëzuar jashtë afatit.”

- Në përgjigje sa më sipërcituar, Shkolla 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë, me shkresën<sup>4</sup> nr. 150 prot., datë 14.09.2024, ka parashtruar në mes të tjerash se:

“Nxënësi E. B. përgjatë vitit shkollor 2023-2024 ka 127 mungesa të arsyeshme, ndërsa në vitin shkollor 2024-2025 paraqitet më mirë me frekuentimin në shkollë vetëm 8 ditë të munguara në periudhën e tre mujorit të parë 9 Shtator -20 Dhjetor 2024.

Nxënësja S. B. përgjatë vitit shkollor 2023-2024 ka gjithsej 95 mungesa nga të cilat 72 i ka të arsyeshme ndërsa në tre mujorit të parë për vitin shkollor 2024-2025 nga 9 Shtator -20 dhjetor 2024 ka një frekuentim jo shumë të rregullt, 21 ditë të munguara në mësim, kryesisht mungesa për arsye shëndetësore.

Përgjatë muajit Janar deri sot S. B. dhe E. B. kanë 6 ditë të munguara.

Mos frekuentim i rregullt shkollës sjell dhe arritje akademike të ulta, por duhet të theksojmë që familja jeton në vështirësi ekonomike për shkak të papunësisë dhe si një familje e madhe me shumë fëmijë. Fëmijët pavarësisht kushteve të vështira ekonomike përpiqen të vijnë në shkollë dhe të reflektojnë sjellje pozitive si respekt për shokët dhe mësuesit, dëshirë për tu arsimuar, dëshirë për tu integruar në shoqëri.

Përsa i përket problematikës së akordimit të bursave edhe në vitin 2023-2024 fëmijët nuk e përfituan bursën për shkak të mungesës së dokumentit të papunësisë por me kërkesë të shkollës me listat shtesë fëmijët e përfituan.

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 145 prot., datë 17.01.2025.

*Shkolla është përpjekur ti ndihmojë edhe më herët duke mbledhur dhe çuar ndihma tek kjo familje”.*

2. Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenit 39, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>5</sup>”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 29, datë 05.03.2025, të Komisionerit, në datën 13.03.2025, nga inspektorët e KMD-së, u realizua inspektimi në ambientet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë.

Objekti i inspektimit ishte marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, në kuadër të shqyrtimit administrativ të kësaj çështjeje<sup>6</sup>.

Gjatë takimit me përfaqësueset<sup>7</sup> e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua se:

- Dokumentacioni i kërkuar për përfitimin e bursës, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, nuk bazohet në asnjë akt shkresor të hartuar apo dalë nga ana e NSHMAÇ/Bashkia Korçë apo Bashkia Korçë, por është vendosur sipas interpretimit që Ndërmarrja, i ka bërë kriteretë të kësaj VKM-je.
- Nuk ka një procedurë konkrete të përcaktuar lidhur me shqyrtimin e trajtimin e dosjeve të aplikantëve për përfitimin e bursës, por nga praktika e krijuar prej tyre, kur gjatë shqyrtimit të dosjeve kanë konstatuar mungesë ose pasaktësi dokumentacioni, kanë kontaktuar verbalisht me drejtoritë e shkollave dhe u janë dhënë udhëzimet rast pas rasti, sipas specifikës të secilës dosje. Drejtoritë më pas kanë lajmëruar prindërit për plotësimin e dokumentacionit dhe u është lënë një afat i arsyeshëm për plotësimin e dorëzimin e tyre.
- Përgjegjësia për plotësimin e dorëzimin e dokumentacionit është e vetë prindit aplikant dhe nuk është përgjegjësi e Ndërmarrjes për ta siguruar, pavarësisht faktit nëse dokumentacioni disponohet nga institucionet vartëse të Bashkisë.

---

<sup>5</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

<sup>6</sup> “Kopje të aktit ku është përcaktuar dhe miratuar lista e dokumentacionit që duhet të depozitohet një aplikant për përfitimin e bursës.

*A ka një procedurë të miratuar lidhur me mënyrën si realizohet shqyrtimi i aplikimeve për përfitimin e bursave dhe afatet kohore? Nëse, po kopje të aktit/dokumentit përkatës ku është e përcaktuar procedura e shqyrtimit. Nëse nuk ka një procedurë të shkruar, informacion të detajuar se si realizohet në praktikë shqyrtimi i aplikimeve për bursë.*

*Kopje të urdhrimit për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e aplikimeve për përfitimin e bursave për vitin 2024-2025.*

*Si dhe çdo parashtrim e dokument, apo akt tjetër provues, që vlerësoni se ndihmon në sqarimin e problematikës së ngritur nga subjektet ankues.”*

<sup>7</sup> Znj. S. Z, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik, znj. K. Z, me detyrë Specialiste në Sektorin e Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe znj. T. H, me detyrë Psikologe pranë NSHMAÇ.

- Për rastin në fjalë, fëmijët S. B. dhe E. B., nuk ishin bërë pjesë e listës së përfituesve të bursave për shkak se prindërit nuk kishin depozituar në dosjet e aplikimit vërtetimin e punëkërkesit të papunë.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Subjekti ankues, pretendon se është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në shkelje të pikës 2.1/c, të VKM-së nr. 511, datë 27.7.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, duke mos u trajtuar rasti i fëmijëve të saj, si pjesë e kategorisë përfituese të bursës për vitin shkollor 2024-2025, me arsyetimin e mungesës vërtetimit të regjistrimit si punëkërkes i papunë për çdo anëtar madhor të familjes. Kërkimi i subjektit ankues para KMD-së lidhet me konstatimin e diskriminimit dhe përfitim të bursës për dy fëmijët e saj.

Në kontekst të legjitimitetit të ankueses kundrejt subjektit ndaj të cilit ka pretenduar diskriminimin, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Korçë gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin (si entitet) për miratimin e dhënien e bursave.

Nga ana tjetër, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë (Ndërmarrja), nuk gëzon legjitimitet pasiv për pretendimin e ankueses për diskriminim lidhur me mospërfitim të bursës për dy fëmijët e saj, pasi nuk ka tagrin e miratimit të dhënies së bursës.

Bazuar në rolin tejet të veçantë dhe specifik që ka Ndërmarrja, si një hallkë shumë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e gjithë procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve përfitues të bursës, pavarësisht faktit se nuk është vendimmarrëse, Komisioneri do të shqyrtojë edhe veprimet e Ndërmarrjes dhe ndikimin që ato kanë pasur tek vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin/mosmiratimin e bursës. Në mënyrë direkte, e gjithë vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin e dhënies së bursave është e bazuar në procedurën e zhvilluar nga NSHMAÇ dhe e kufizuar në listën e aplikantëve përfitues, të përcjellë prej saj.

*Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankueses, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm të saj nga ana e Bashkisë Korçë.*

Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, në nenin 1, të tij përcakton se: *“Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njërive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse”*.

Neni 9, pika 1.1/ç), i Ligjit<sup>8</sup>, përcakton se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës:

...ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre”.

Në nenin 24<sup>9</sup>, i Ligjit, përcakton se, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, ndër të tjera dhe: “... Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit, etj. sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike, janë përcaktuar në nenin 33, të Ligjit, duke parashikuar se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

- a) njësi organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;
- b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;
- ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

.....

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.”

VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

...4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa

<sup>8</sup> Referuar ligjit sipërcituar me nr. 139/2015, i ndryshuar.

<sup>9</sup> Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale.

*financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.*

*5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.*

...

*8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënie bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.”*

VKM nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

*“23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave/konvikteve, ku nxënësit studiojnë....”*

Në këtë kuptim, bazuar në sa më sipër, Komisioneri do vijojë trajtimin e ankesës duke analizuar faktin nëse fëmijët e ankueses plotësojnë kushtet për përfitimin e pagesës për nxënësit e arsimit parauniversitar bazë në institucionet arsimore publike, në zbatim të pikës 2.1/c, të VKM-së sipërcituar, si dhe, nëse skualifikimi i tyre (për mungesë në dokumentacionin e dorëzuar) është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

***Në analizë të legjislacionit, dokumentacionit dhe informacionit të depozituar nga palët, Komisioneri vëren se:***

Bazuar në deklaratimet e palëve, pranohet fakti se, fëmijët e ankueses, kanë përfitur bursë për vitin shkollor 2023-2024, nga fondet e Bashkisë (sipas VKB nr. 164, datë 29.12.2023).

VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

*“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:*

.....

## 2.1 Kriteri ekonomik:

.....

*c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë”.*

Për të qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025, sipas klasifikimit në kriterin 2.1/c, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, dokumentacioni që kërkohet për të aplikuar për bursë sipas këtij kriteri, nga Bashkia Korçë, është:

- Certifikatë personale.
- Certifikatë familjare.
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës).
- Vërtetim të ardhurash/page për çdo anëtar madhor të familjes.
- Vërtetim regjistrimi si punëkërkuar i papunë për çdo anëtar madhor të familjes.
- Vërtetim pagese pension pleqërie.
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes.

Referuar provave dhe informacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se ankuesja ka aplikuar për të përfituar bursën për fëmijët e saj por nuk i plotëson kushtet për të përfituar sipas legjislacionit të sipërcituar, pasi ajo dhe bashkëshorti nuk figurojnë punëkërkuar të papunë nga Zyra Vendore e Punësimit Korçë, gjithashtu nuk rezultojnë përfitues të skemës ekonomike/sociale, si familje në nevojë.

Sa më sipër, ankuesja gjatë parashtrimeve të bëra në formularin e ankesës ka deklaruar se: *“...nuk trajtohem me ndihmë ekonomike prej një periudhe kohore disa vjeçare. Shkak ka qenë penalizimi që më është bërë, pasi nuk kam pasur informacion dhe nuk kam deklaruar pagën në zyrën e Ndihmës Ekonomike...”*.

Në lidhje me pretendimin se familja e ankuseses ndodhet në vështirësi ekonomike, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr. 57/2019 *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, sipas përcaktimeve të nenit 3, të tij, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të vendosura në nenin 11 të këtij ligji.

Në nenin 4, të këtij Ligji, ndër të tjera përcaktohet se:

*“Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:*

.....

*c) “Bashki/njësi administrative”, është institucioni nën juridiksionin e të cilit personat përfitues, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar mbështetje me të ardhura monetare ose/dhe në natyrë, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për të kërkuar mbështetje për adresimin*

e situatës së tyre social-ekonomike drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të punësimit, strehimit;

d) “Familje”, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, të cilët jetojnë në të njëjtën strehë;

e) “Fëmijë”, është çdo person nën moshën 18 vjeç dhe, në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;

.....

k) “Ndihma ekonomike”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

Në kreun II, “Përfituesit e asistencës sociale”, neni 6, i po këtij Ligji, përcakton se: “Asistenca sociale përfshin, por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera, që garantohen nga ky ligj.”

Sipas nenit 7, “Përfituesit e ndihmës ekonomike”, shkronja a, e tij, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.”

Neni 7 i LMD-së<sup>10</sup>, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Komisioneri vlerëson se, referuar provave rezultoi se ankuesja ka aplikuar për të përfituar bursën për fëmijët e saj, pranë institucionit por nuk ka plotësuar kushtet për të përfituar sipas legjislacionit të sipërcituar, pasi ajo dhe bashkëshorti i saj nuk figurojnë dhe nuk kanë dorëzuar vërtetimin si punëkërkuar të papunë në Zyrën Vendore të Punësimit Korçë. Gjithashtu, ankuesja nuk rezulton të jetë përfituese e ndonjë skeme të ndihmës/sociale, si familje në nevojë.

<sup>10</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se fëmijët e ankueses nuk janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Korçë.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me trajtimin e rastit të nxënësve S. B. dhe E. B., kundër Bashkisë Korçë. Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7/1, nenin 11, nenin 32, pika 1, shkronja b) e nenin 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve S. B. dhe E. B.<sup>11</sup>, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja ekonomike)  
(Fusha: Arsim)

---

<sup>11</sup> Përfaqësuar nga nëna, B. B.